



KUJTOHUNI TË MERRNI ME VETE:

- Pasaportë** brenda periudhës së vlefshmërisë.
- Një dokument që të vërtetojë që keni një leje qëndrimi të rregullt në Itali**, ose:
Leje ose kartë qëndrimi në kopje origjinale, të lëshuara nga Policia e Lukës (Questura di Lucca), ose dokumenti që vërteton që keni bërë kërkesë për përtëritje të këtyre dokumenteve, ose në rastet e parashikuara për hyrje në vend për arsye familjare/pune (duke pasur me vete vërtetimin e Sportelit të Vetëm për Çështjet e Imigracionit - Sportello Unico per l'Immigrazione):
 - ✓ *riçevutë e kërkesës që keni paraqitur për lejen e parë të qëndrimit përmes Postës Italiane (ose përmes formave të parashikuara me ligj)*
 - ✓ *pasaportë me vizë hyrjeje (për arsye familjare ose pune) të lëshuara nga autoritetet konsullore italiane të vendit të origjinës;*
 - ✓ *kopje jo e autentifikuar e vërtetimit të Sportelit të Vetëm për Çështjet e Imigracionit (Sportello Unico per l'Immigrazione);*

Gjithsesi, riçevutat e kërkesave për përtëritjen e lejes së qëndrimit ose të kërkesës për marrjen e lejes së parë të qëndrimit duhet të jenë të lëshuara nga Policia e Lukës (Questura di Lucca). Kur ato lëshohen nga provinca të tjera, duhet të dorëzoni riçevutën e deklaratës të këtij ndryshimi, të paraqitur përmes Postës Italiane (ose gjithsesi në format e parashikuara me ligj).

Për leje qëndrimi për periudha më të shkurtra se tre muaj të persona që rrjedhin nga persona qytetarë italianë - që gjenden përkohësisht në Itali - që dëshirojnë që përfitojnë njohjen e qytetarisë italiane me anë të së drejtës së afërsisë së gjakut, si dhe për ish bashkatdhetarë që dëshirojnë të ri marrin qytetarinë italiane: dokument të deklaratës së pranisë të lëshuar:

 - ✓ *për ata që nuk vijnë nga zona Shengen, Autoriteteve kufitare në momentin e hyrjes së tyre në Itali (detyrim që u plotësua edhe me vendosjen e vulës përkatëse Shengen në pasaportë në momentin e hyrjes);*
 - ✓ *për ata që vijnë nga një vend i zonës Shengen, tek dega e Policisë kompetente, brenda 8 ditëve nga hyrja në Itali.*

Duhet gjithashtu paraqitur një deklaratë/dokument që vërteton kushtet e prejardhjes nga një qytetar italian ose që vërteton shkallën e ecurisë së statusit të tij/saj si qytetar italian/e.
- Kodi fiskal**, i lëshuar nga Zyrat e Agjencisë së të Ardhurave (Ufficio Agenzia delle Entrate)
- Çertifikata e martesës ose e vejjshës/vesë, ose të personit të divorcuar, si dhe dokumenti që vërteton afërsinë fisnore në bërthamën familjare. Kjo duhet të jetë në gjuhën origjinale, e legalizuar dhe e përkthyer në italisht nga Konsullata ose Ambasada e Italisë në vendin e origjinës, OSE nga Ambasada e vendit të vet në Itali, si dhe të legalizuara nga Prefektura e Lukës (Prefettura di Lucca).
- Nëse hyni si pjesëtarë në një bërthamë familjare që është banore që më parë, sigurohuni që të keni me vete **deklaratën e pëlqimit** të një përbërësi në moshë madhore të familjes (modeli gjendet tek ekspozuesi i formularëve).

Kujdes: Qytetarët jashtë komunitarë duhet të paraqesin tek shërbimet e gjendjes civile deklaratën e vend banimit, pas çdo përtëritje të lejes së qëndrimit (brenda 60 ditësh).